

V E N D I M

PER PRISHJEN ME NENVIZIM

Une Gjyqtare Anila CAPO, prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, sot me date 18/10/2003 (dy mije e tre) pasi shqyrtova kerkesen me :

KERKUES : *Sizajete GURI*, e bija e Kasemit, e dtl. 1955, lindur dhe banuese ne Vlore, Lagjia Pavaresia, pall. 1383. Perf. me Prokure nga z. Vladimir HODAJ.

OBJEKTI : Kerkohet prishja me nenvizim e rregjistrimit te paligjshem per mungese kushti themelor, te bera me vendimin Nr. 7877/2 date 31.10.2001 te gjyqtares se vetme me kerkesen e ish ortakut themelues te Shoqerise ERJONI Sh.p.k. z. Ylli GURI

Baza Ligjore . Neni 19 i Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregetar " dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare .

K O N S T A T O V A

- Me Vendimin **Nr. 7877 date 05.01.1995** eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar " **ERJONI " Sh.p.k.** me ortak te vetem themelues dhe Administrator z. **Ylli GURI**, me kapital themeltar 100.000 leke dhe seli ne qytetin e Vlores .
- Me pas, me Vendimin **Nr. 7877/1 date 26.07.2000** eshte vendosur depozitimi i **Vendimit Nr. 1 date 20.07.2000** i ortakut te vetem te shoqerise " **ERJONI " Sh.p.k.** ku behet fjale per *largimin e z. Ylli GURI* si ortak dhe Administrator nga kjo shoqeri dhe *pranimin e zj. Sizajete GURI* si ortak e vetme dhe Administratore e Shoqerise **ERJONI Sh.p.k.** Z. Ylli GURI eshte emeruar si Drejtues Teknik i Shoqerise pasi aktiviteti i kesaj shoqerie do te ishte kryesisht ne ate te fushes se ndertimit . Per te plotesuar praktiken ne baze te ligjit eshte redaktuar edhe Kontrata e shit- blerjes se kuotave te kapitalit themeltar me **Nr. 1466 Rep dhe Nr. 131 Kol. tek Notere Lumturi CULAJ** ku behet fjale qe Bleresia Sizajete GURI i ble 100 % kuotat e kapitalit themeltar te Shoqerise **ERJONI Sh.p.k.** nga shitesi Z. Ylli GURI.
- Ne vijim, gjyqtarja e vetme, me Vendimin **Nr. 7877/2 date 31.10.2001** ka vendosur :
 - **Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ana e " Administratorit " z. Ylli GURI.**
 - **Depozitimin e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise " ERJONI " Sh.p.k. date 25.10.2001 i cili ka vendosur shitjen e " kuotave te zoteruara prej tij ne masen 100 % " bleresit z. Irfan HYSENBELLIU.**

- Kërkojme , pikerisht prishjen me nenvizim te regjistrimit ne Rregjistrin tregetar te vendimit te mesiperm per aresyet e meposhteme :
- Nga kronologjia e tere praktikes se Shoqerise “ **ERJONI “ Sh.p.k.** rezulton se ne baze te ligjit te drejten per te marre vendime lidhur me shitjen , tjetersimet apo cfaredolloj ndryshimi ne shoqerine e mesiperme e ka vetem ortakja e veteme dhe Administratoia e ligjshme **zj. Sizajete GURI** . (*Permendim perseri qe z. Ylli GURI eshte larguar nga kjo shoqeri ne baze te vendimit Nr. 7877/1 date 26.07.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane*) .
- Pra, ne menyre te kundraligjshme z. Ylli GURI i ka dhene vetes perseri cilesine e Ortakut te vetem dhe Administratorit te shoqerise duke firmosur Vendimin e Ortakut te vetem lidhur me vendimmarrjen e shitjes se kuotave ne masen 100 % **z. Irfan HYSENBELLIU** .
- Perseri , ne menyre te kundraligjshme , z. Ylli GURI ka nenshkruar Kontraten e Shit-Blerjes se Kuotave me **Nr. 9157 Kol dhe Nr. 1363 Rep. tek Noter Agim ROBO** ku behet fjale per shitblerjen e te gjitha kuotave te **ERJONI Sh.p.k.**
- Dhe , se fundi nen cilesine e “ Administratorit “ ka paraqitur kerkesen perkatese per depozitim ne Gjykatën e Rrethit Tirane , e cila me Vendimin e saj Nr. 7877/2 date 31.10.2001 pa patur asnje nga kushtet themelore ligjore te mesiperme ka vendosur depozitimën e dokumentave .

PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 19-20 te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 dhe Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses se kerkueses Sizajete GURI .
- Prishjen me nenvizim te vendimit te gjyqtarit te vetem me Nr. 7877/2 date 31.10.2001 qe ka vendosur
- **Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ana e “ Administratorit “ z. Ylli GURI . Depozitimën e vendimit te ortakut te vetem te shoqerise “ ERJONI “ Sh.p.k. date 25.10.2001 i cili ka vendosur shitjen e “ kuotave te zoteruara prej tij ne masen 100 % “ bleresit z. Irfan HYSENBELLIU per mungese te kushteve themelore**
 - Urdherohet Zyra e Rregjistrimit te beje ndryshimet perkatese .
 - Kunder ketij vendimi mund te behet ankim

GJYQTARE
Anila CAPO

